




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË



Nr. 02/ 96
Datë: 15.04.2025



Procesverbal
i mbledhjes së -IV- (katër) të Komitetit për Komunitete

PRANUAR MË:
ACCEPTED ON: 15/04/2025
IMLJENO: 02/96

REND DITE

- 1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .
- 2.Takimi me z. Agron Kastrati nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas.
- 3.Vizitë në HANDIKOS në Malishevë.
- 4.Të ndryshme.

Takimi filloi ne ora :10:14 në të cilën morën pjesë katër antarë të Komitetit për Komunitete,musafirë zotri Agron Kastrati zyrtar nga zyra për Ndihmë Juridike Falasa,zyra e Informimit dhe sekretaria e Kuvendit.

Kryesus i Komiteti për Komunitete Amrush Helshani: Përshëndetje për të gjithë dhe të nderuar antarë të Komitetit për Komunitete i nderuar zotri Agron Kastrati zyrtar për Ndihmë Jurike Falas në Komunën e Malishevës ,të nderuar sekretari e Kuvendit i nderuar zotri Agron Paqarizi zyrtar nga zyra e Informit ju falenderoj të gjithëve për prezencën tuaj.
Sot jemi në mbledhjen e katër të rregullt të Komitetit për Komunitete e cila për rend të ditës ka këto tema:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar .
- 2.Takimi me z. Agron Kastrati nga Zyra për Ndihma Juridike Falas.
- 3.Vizitë në HANDIKOS në Malishevë.
- 4.Të ndryshme.

Kryesus i Komitetit për Komunitete Amrush Helashi:Për momentin jemi prezent 3 antarë korum kemi me leje mungon zotri Muharrem Islamaj shumë shpejtë na bashkangjitet kolegja Sakibe Kryeziu .

A ka dikush ndonjë propozim për rendin e ditës ndonjë temë,diskutim sa i përket rendit të ditës ?
Atëherë e hedh në votim rendin e ditës për mbledhjen e katër të Komitetit për Komunitete kush është për .
Ju faleminderit .

Miratohet rendi i ditës me vota unanime.

Për 3 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 vota.

Pika e parë e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

Kryesus i Komitetit për Komunitete Amrush Helashani: Të nderuar antarë përpara vetës e keni procesverbalin nga mbledhja e kaluar. Nëse keni diskutim sa i përket këtij procesverbalit nëse keni ndonjë vrejtje apo plotësim të procesverbalit ju lutem paraqiteni .A dëshironë dikush fjalën sa i përket procesverbalit ?

Atëherë e hedhim në votim miratimin e procesverbalit nga mbledhja e kaluar kush është për?

Ju falenderoj. Miratohet procesverbali nga takimi i tretë i rregullt i Komitetit për Komunitete .

Për 4 vota.

Kundër 0 vota.

Abstenim 0 Vota.

Kryesus i Komitetit për Komuniteteve Amrush Helshani: Unë kërkoj nga sekretariati i Kuvendit që në kohë të dërgojë procesverbalet e miratuara të mbledhjeve të këtij komuniteti në Zyrën e Informimit. Këto procesverbalet janë obligative që të publikohen në veb faqën e Komunës së Malishevës kërkoj që sekretaria të jetë më bashkëpunuese edhe me Zyrën e Informimit që me kohë të njoftojë për mbledhjet e këtij komiteti sigurisht që edhe të raportoj të publikoj procesverbalet e secilës mbledhje të mbajtur nëse është e lejuar edhe të mbledhjeve të kaluara të publikohen .

Të gjitha procesverbalet janë të përfunduara përveq tre apo katër proceverbale të vitit të kaluar të cilat nuk na kanë ardhur për miratim këtë shqetësim unë e kam paraqitur edhe në mbledhjet e Kuvendit mirëpo këto nuk kanë ardhur në komitet për tu miratuar kështu që kjo është përgjegjësi e sekretariatit të Kuvendit pasi që mbledhjet janë mbajtur .

Unë e kam cekur nëse ka mungesë të punëtorve ai nuk është problem i asnjë prej antarëve të komitetit është dikush tjetër që meret dhe e arsyeton këtë problem.

Kjo është kërkesa ime sa i përket sekretariatit të Kuvendit për procesverbalet e secilit takim.

Atëherë ju faleminderit pas miratimit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar vazhdojmë me pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës: Takimi me z. Agron Kastrati nga Zyra për Ndihma Juridike Falas.

Kryesus i Komitetit për Komunitete Amrush Helashani: Zotri Agron Kastrati është zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas në Komunën e Malishevës një bashkëpuntor shumë i nderuar i pranuar për të gjithë unë ju përgëzoj për punën dhe të gjithë angazhimin që e bënë kjo zyre me qytetarët e Malishevës sigurisht që ne jemi në kontakt e përcjellim aktivitetin por qëllimi i këtij takimi është që antarët e këtij komuniteti mu njoftuar me punën dhe veprimtarinë e kësaj zyre sepse të gjithë jemi në kontakt të vazhdueshëm me qytetarët e Komunës së Malishevës ndoshta edhe me ata që kanë nevoja mirëpo nuk din ku mu drejtu dhe orientu por besoj që kjo zyre ofronë mjaftë shërbime të cilat mund ti përfitojnë qytetarët e Komunës së Malishevës .

Antarët e këtij komuniteti sigurisht që janë të informuar mbi punën ose kanë hulumtuar mbi veprimtarinë e kësaj zyre dhe kanë të drejtë të parashtojnë pyetje për juve .

Unë të felenderoj në emër të gjithë antarëve për prezencën dhe me dëshirë ju kisha kaluar fjalën që ta bësh një prezantim të punës dhe veprimtarisë së kësaj zyre .

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Përshëndejte për të gjithë ,unë jam Agron Kastrati zyrtar ligjor nga Agjensia për Ndihmë Juridike Falas nga Komuna e Malishevës,fshati Turiak si zyre në Malishevë ka filluar të funksionalizohet prej vitit 2019-të zyra për Ndihmë Juridike Falas e cila sipas ligjit quhet Zyra Mobile për Ndihmë Juridike Falas ku Zyrën Qëndrore e kemi në Prishtinë dhe Zyra regjionale në të gjitha regjionet mirëpo në Malishevë nga viti 2021-9-të ka filluar së funksionuari si institucion i pavarur Agjensia për Ndihmë Juridike falas mirëpo nga viti 2021-të ka kaluar nën ombrellën e Ministrisë së Drejtësisë e cila menagjon si institucion por normal e kemi edhe Zyrën Qëndrore .

Në bazë të ligjit për Ndihmë Juridike falas funksionojnë edhe Zyra për Ndihmë Juridike falas në Prishtinë edhe nëpër komuna kudo që jemi.Në vitin e kaluar si zyrtar për Ndihmë Juridike falas kam pas me mbuluar edhe Komunën e Klinës për shkak të mungesës së zyrtarve atje e kemi kryer si mision e kemi marrë një zyrtar me qëndrueshmëri të përhershme ashtu siq jam une për Malishevë tani nga fillimi i këtij viti e mbuloj edhe Komunën e Rahovecit që tre ditë jam në Malishevë të hënën,martën dhe mërkurën kurse të enjtën dhe premtën jam në Komunën e Rahovecit për këtë fillim të vitit .

Si zyre ne ofrojmë shërbime juridike falas ose si institucion sepse realisht edhe juridikisht jemi institucion i shtetit ofrojmë shërbime falas në të gjithat lëmit:penale,civile,administrative dhe kundërvajtje këto ndihma juridike falas ofrohen për të gjithë qytetarët të cilët nuk kanë ndihma financiare të mjaftueshme pra kur rezikohet mirëqenia e tyre e që vijnë në kategoritë sipas ligjit e të cilat ndahen për kategoritë primare dhe sekondare aty hyjnë të gjithë personat që marjnë pensione në skemat pensionale të Republikës së Kosovës,familjet me asistencë sociale,veteranët e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe kategoritë e tjera pastaj të cilat i kemi kategoritë tjera sipas plotësimit ndryshim të cilat janë shumë primare siq janë viktimat e dhunës në familje,studenta,viktimat e trafikimit me qenie njerzore e shumë kategorië të tjera.

Shërbimet e Avokatit ofrohen në të gjitha lëmit siq e përmenda duke përfshirë shkresa,parashtresa,kërkesa më saktësisht ankesa,padi nvalet prej problemit të tyre juridik që e kanë.

Misioni i Agjensisë është që të ju ofrojë Ndihmë Juridike Falas të gjithë qytetarëve pa dallim,pa dallim race,gjinie,kombësie apo komuniteti edhe ato shërbime ju ofrohen në mënyrën më të mirë të duhur sipas ligjit.

Periodha prej vitit 2019-të e deri tani kemi pasur shumë raste që i kemi ndihmuar në Komunën e Malishevës por edhe në Komunitet e tjera që jam dhe vetëm se e kam përfunduar misionin e Klinës edhe atje kemi pasur shumë raste që ju kemi ofruar mbështetje dhe rëndësia e këtij institucioni është e madhe nëse e krahasojmë me shtetet e tjera të cilat e kanë një sistem të tillë shteti jonë e ka shumë më të mirë këtë sistem sepse e ofronë në katër lëmit dhe atë falas pa asnjë cent për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Si krahasim që e thashë në shtetet e tjera të Evropës ka raste kur mbështetjen e ofrojnë vetëm në një lëmi përshembull falas kurse në lëmit e tjera duhet me participu pas përfundimit të rastit nëse është i suksesshëm rasti atëherë duhet me pagu institucionin në rend të parë një shumë të caktuar ka shumë dallime por kjo është si një pikë e rëndësishme e institucionit dhe shtetit tonë që e ka themeluar dhe funksionalizuar në mënyrë të tillë për me ju ofruar shërbime për Ndihmë Juridike Falas.

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani:Na thuaj konkretisht sa raste janë trajtuar vitin e kaluar ?

Agron Kastrati zyrtarë nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas :Gjatë vitit të kaluar për vitin 2024-të vetëm në Komunën e Malishevës afërsisht i kemi trajtuar 222(dy qind e njëzetë e dy) të gjitha kanë marrë vepërime juridike .

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani:Sa raste për shembull kanë qenë të suksesshme ?

Agron Kastrati zyrtarë nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas :Kam përpiluar kërkesa,ankesa,padia me përqindje saktësisht nuk mundem me nxjerë ndonjë statistik sepse nuk e kam ditur mirë agjendën mirëpo kemi shumë raste të cilat janë në dobi e mar një shembull te skemat pensionale me pensione të dyfishta që kanë filluar në vitin 2024-të të gjithë pensionistët ose personat që kanë qenë duke e marë një pension po e marë shembull veteranin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës apo veteranin e viktimave civile apo familjes së viktimave civile që kanë qenë duke e marë një pension tjetër kurse nuk kanë mundur me marë pension e pleqërisë pension e moshës kriteret ligjore i ka plotësuar mirëpo është dashur mu ndjek procedura sepse e kemi si bazë ligjore vendimin e gjykatës supreme që e ka vërtetë se qytetari duhet me i gëzuar dy pensione.

Të gjitha këto raste i kemi ndjekur me procedura me padi në Gjykatën Administrative tani i kemi raste që janë duke ardhur që kanë vendosur kanë shpallur dakort Departamenti për qështje Administrative ju ka njohur të drejta edhe për pensionin e pleqërisë mirëpo për shkak të planifikimit financiar të shtetit të Ministrisë së Financave atje të thesarit Departamentit të Pensioneve ende po shkojnë me procedura të zvaritura të cilët po ankohen dhe vendimet po shkojnë në Gjykatën e Apelit mirëpo derisa të vendos edhe Gjykata e Apelit më saktësisht nuk mundet me ju njohur e drejta,mirëpo deri në këtë fazë kemi raste që janë në dobi të qytetarëve kjo është sukses sepse nëse e bëjmë krahasimin me Avokatët privat qytetarët nëse dëshirojnë me angazhu Avokat privat nuk ju cenohet e drejta e tyre mirëpo përmes zyrës për Ndihmë Juridike Falas shteti ju ka garantu qytetarëve me marë shërbime juridike falas pa paguar asnjë cent kurse me shku te Avokati privat pala duhet me bërë pagesën vetë e cila i kushtonë një shumë e lart vetëm për përpilimin e padisë e kjo është mundësia që shteti e ka kriju si zyre.

Ne jemi gjdo herë në konsulltim me të gjitha zyrat tona në mbrojtje të ligjit dhe zbatim të saj të drejtave dhe lirive themelore të njeriut të cilat janë të parapara me Kushtetutë dhe ligje tjera. Pavarsisht që kemi raste të ndryshme unë e ceka vetëm rastin e skemës pensionale por ne kemi raste edhe të lëmisë civile ku i kemi të suksesshme raste penale ,raste në kundërvajtje janë lëmi që ja dalim me sukses që i derivohen zyrës institucionit të shtetit por më e rëndësishmja është që pala kur e mer me sukses ndonjë rast ne jemi edhe më të kënaqur si zyre si zyrtarë të Ministrisë së Drejtësisë në këtë rast.

Përveq këtyre aktiviteteve të ndryshme ne mbajmë takime me përfaqësues akterë institucional jemi pjesë e nënshkrimit të marrëveshjes të memorandumit në bashkëpunimin e themelimit e organizimit kundër dhunës në familje.

Tani në Malishevë kam raporte dhe bashkëpunim të mirë me Zyrën për të Drejtat e Njeriut me zyrtarën zonjën Vlora Bytyqi por edhe me të gjithë akterët tjerë në nivel lokal.

Ka raste kur tek qytetarët ende mungonë informimi për këtë zyre dhe kur shkojnë në institucionet përkatëse ata i njoftojnë për zyrën tonë që të udhëzohet e cila gjindet në objektin e stacionit të autobusëve në katin e parë afër zyrës së pensioneve aty është Zyra për Ndihmë Juridike Falas aty janë detyrat sipas ligjit dhe autorizimit që i kemi.

Lirisht mundemi mem ndërpre nëse kemi me bërë ndonjë pyetje. Ne kemi pasur rast që kemi trajtuar edhe nga komunitetet tjera siq janë boshnjak, romë pra kemi raste që ju kemi ofruar mbështetje dhe kanë pasur sukses rastet e tyre .

Zamira Morina antare nga Komiteti për Komunitete: Cilat janë sfidat më të mëdha që përballet kjo Zyre për Ndihmë Juridike Falas në nivel lokal?

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas: Realisht sfida nuk kemi, unë jam një tik elastik dhe shumëbashkëpunues edhe kur ka qenë objekti i Qendrës për Punë Sociale sipas marrëveshjes që e kanë nënshkruar institucioni jonë me zyrën e Kryetarit të Komunës e kanë siguruar një zyre për me ofruar shërbim në interesë të qytetarët e komunës tonë unë e kam pasur një grup të vogël dhe kanë funksionuar kurse tani që ka kaluar Qendra për Punë Sociale sipas planit të Komunës edhe aty i kemi kushtet shumë të mira e kemi zyrën, kanë vendosur edhe një klimë i kemi kushtet e mira disa gjëra teknike mi kanë sjellur edhe zyra qëndrore atje edhe funksionojë shumë mirë .

Sfidë mundet me qenë pasi tani jam tre ditë në Malishevë mirëpo unë e kam lënë një mundësi e kam shkruar numrin kontaktus në derë pasi që në zyre unë jam i vetëm si zyrtar dhe nuk kam dikën tjetër me lënë në zyre për të më zëvendësuar në ditë të punës sepse ne ndonjëherë kemi bashkëpunim me Avokatët sepse ne kemi raste që i angazhojmë te Avokatët privat për lëmi civile familjare, pronësore , trashigimore apo të natyrave të tjera dhe ato raste kur i angazhojnë ne i monitorojmë si zyrtarë dhe shpeshëherë duhet me dalë tek ndonjë Avokatë me shiquar mos e kanë ndonjë fakturë për veprimet që i kanë ndërmarë për rastin dhe pasatj ato faktura mi marë dhe mi dorëzu tek zyra për pagesë.

Si sfidë mundet me qenë që shpeshë palët nuk munden mem gjetur në zyre por palët e shohin numrin në derë dhe mund të më kontaktojnë dhe ne pas kontaktit e caktojmë orën kur mundemi mu takuar .

Kryesus i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani: U përmendën shumë tema, dua të ndalem tek siguria në punë a është trajtuar ndonjë rast prej zyrës tuaj a ka kërkesa apo thjeshtë është detyrë e Inspektoriat për Punë, a ka kërkesa prej qytetarëve për ti orientuar lidhur me sigurimin në punë sepse kemi raste përshembull edhe me fatalitet, thjeshtë dëshirojë me ditë a ka kërkesa a trajtohen.

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas: Për këtë vitë e kam një rast tek qështja e marrëdhënies së punës, kontekst i punës që i kam ofruar një mbështetje por dallon lëmie e saj me qështjen e sigurisë.

Te qështja e sigurisë apo e ndërtimtarisë këto kam pasur raste mirëpo i kam ofruar si këshillim sepse shpeshë herë kur palën e këshillonë dhe i thua që kjo është veprimi që duhet me ndërmarë shpeshë hezitojnë me preteksin se mos dalë keq para shefit heqin dorë nuk dëshirojnë me vepru asgjë.

Një rast e kam pasur të gjinisë femore nga Komuna e Rahovecit këtë vitë ja kam ofruar një shërbim juridik falas e cila ka pasur një kontekst në marrëdhënien e punës me OJQ përyeq që nuk

ja kanë vazhduar kontratën e punës të cilën e ka pasur për gjdo vit sepse ka pasur kontratë njëvjeqare të cilës ja kanë shkëputur kontratën me arsyje që kjo pala e ka dëmtuar reputacionin e OJQ-së dhe i ka shkaktuar dëm donatorit të OJQ-së deri në atë masë që pala me kompenzuar OJQ-në në vlerëm mbi 9000€ (nëntë mijë euro) me obliguar Gjykata që pala e Rahovecit për me paguar kompenzimin .

Ne si zyre i kemi ofruar palës mbështetje dhe Gjykata e ka pranuar njoftimin e lëndës dhe ne jemi duke pritur përgjegjjen që me hudhë këtë kërkesën sepse është në dëmin e palës nga Rahovecit sepse ajo thjeshtë nuk ka pasur diqka që e ka humbur reputacionin e OJQ-së sepse ajo ka kërkuar diqka që është më e drejta elementare e gjdo njeri për të drejtat në punë .

Te sigurimi në punë ka raste ku shpeshë hezitojnë puntorët me marrë kompenzimin në punë sepse nuk dëshirojnë mu prish me shefin sepse kanë frikë se mos e ndërpresin kontratën.

Kam pasur rastin e një mësim dhënësit ku nga veprimet institucionale është ndërpre aktemrimi i tij atëherë i kam ofruar ndihmë në angazhimin e Avokatit për dy të drejta ose kthim në vendin e punës ose kompenzimin e pagave për atë periudhë të punës sipas provave që i ka pasur.

Pasi që është bërë ekspertiza në Gjykatë nga ekspertja e Gjykatës besoj që e dini si janë ekspertat kur i angazhonë Gjykata që nxjerrin ekspertiza financiare e në atë rast vjenë një ekspertizë që është i dëmtuar ish i punësuar dhe e ka njoftur afërsisht një shumë në vlerën prej 8000 € (tetë mijë euro) për palën kthimin e pagave,ndoshta pala ka qenë e pa kënaqur por thjeshtë pala e ka pasur një përfaqësim ligjor pa asnjë cent pa paguar nëse pala kishte me angazhuar një Avokat privat shumë do të kishte qenë shumë e lartë afërsisht 2000 €(dy mijë euro).

Kemi raste të natyrave të ndryshme.Si zyre për Ndihmë Juridike Falas të gjithë ata persona qytetarë të cilët kanë të ardhura financiare nën pagën minimale me ligjin e Kosovës munden me marrë shërbime juridike falas në Zyrën për Ndihmë Juridike Falas në Malishevë.

Amrush Helashni:Faleminderit shumë zotri Agron Kastrati.

Sakibe Kryeziu antare nga Komiteti për Komunitete:Cilat janë problemet juridike më të shpeshta që përballen qytetarët ku drejtohen ata ?

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Të drejtat e qytetarëve janë të shumta mrëpo problemet e qytetarëve janë të ndryshme por problem edhe sfidë është edhe nga niveli qëndror sepse gjysma e buxhetit shkonë për skemat pensionale e tani si zyre kemi më shumë të lëmisë administrative që hyjnë skemat pensionale ose sociale .

Tek pensionale hyjnë të gjitha ato kategori që kanë problem me pensionë të cilat në bazë të ligjit ose vendimit më saktësisht të Gjykatës Supreme duhet me gëzuar edhe pensionimin e dytë mirëpo nuk e gëzojnë për shkak të zvarritjes e cila po merrë kohë edhe mungesa e financave të shtetit mos planifikimit të shtetit që duhet të bëhet planifikimi i shtetit kur të bëhet buxheti në Kuvend e shumë qështje të tjera.

Por a ka a munden mu bërë më tepër duhet bërë iniciativa sepse edhe përneve është sfidë,zhënjim kur ne vet i themi qytetarit mos shko në atë rrugë sepse janë duke dashur me ju mashtruar ata prapë e zgjedhin atë rrugë ne ju kemi thënë sepse është bërë një qështje shumë e madhe tek pensionistat po flas më tepër për ata sepse i përket të gjithëve edhe personave me aftësi të kufizuar po i përmendi më shkurt sepse këtu hyjnë edhe skemat pensionale sepse është bërë një lajm një njoftim këtu në Malishevë dikush po involvohet me nxjerrë një kompenzim për

pensionistat prej inflacionit. Inflacioni është termë ekonomik që nënkuptonë për rënien ekonomike të shtetit por në kuadër të këtij inflamacioni i cili është i përcaktuar për ligjin për skemat pensionale e financuar nga shteti aty thotë që shteti Qeveria ka të drejtën në bazë të inflacionit të shtetit ose me rit ose me zvogëluar pensionet tani për me nxjerrë një kompenzim nuk ka dispozit ligjore që interpretohet.

Ne ju kemi thënë mos shkoni me aplikuar në x vendi të cilën nuk po e përmendi edhe prapë nuk kanë ndëgjuar pensionistat kur kanë shkuar me aplikuar atje me dërgu kinse një vendim të pensionit një kërkesë apo diqka tjetër atje jau kanë ndalur nga 2 €(dy euro) ose 3 €(tre euro) në Prizren ka pasur afërisht 23 €(njëzetë e tre euro) që ja kanë ndalur pensionistave dhe me thënë ka qenë kompletë mashtrim .

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani : A është marrë dikush me këtë rast ?

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas: Sa kam informacion janë marrë mirëpo epilogun e saktë nuk e di të asaj qështje .

Kjo neve na bënë një sfidë sepse kur e shohim që po mashtrohet në raport me të drejtën e njeriut duhet të përballohem me gjithqka tani kemi edhe raste të dhunës në familje që nganjëherë kemi shumë komplikime me të cilën vjen pala e mer shërbimin për shembull sot e angazhojë Avokatin për zgjedhjen e martesës për besimin e fëmijëve, alimentacion edhe pse unë kam të drejtë afërsisht pesë ditë pas kërkesës së palës me pritë me zvarritë pesë ditë është afat ligjor e mbasë ditës së pestë me i ofruar shërbim që ne e konstatojmë që brenda kësaj periudhe mundet me pasë mëdyshje, ndoshta kalonë ajo periudhë që une e zvarrisë jashtë procedurës për me parë që a është e vërtetë a kanë vendosur me i prish ato të drejta familjare mirëpo ka ndodhur rasti që i kemi angazhuar Avokatin i kanë bërë ato veprime i kanë rregjistruar në databazë mbasë dy ose tre dite deklarohet se është penduar. Veprimet janë nisur ne nuk guxojmë sipas ligjit me të ndëgjuar si për shembull si viktimë edhe me të ndërpre sepse një problem në të ardhmen ne mbesim shkaktarët e saj e kështu ne e lojmë në procedurë kur ta shqyrtonë Gjykata pala shkonë e jep një deklaram nëse janë bërë bashk dhe nuk dëshironë me prish martesën hudhet padia poshtë që është inicuar edhe këto nganjëhere na dalin si sfida .

Sakibe Kryeziu antare nga Komiteti për Komunitete: Do me thënë shtresa e popullsisë e personave me aftësi të kufizuar kanë të drejtë Ndihmë Juridike Falas ?

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas: Po absolutikisht kanë të drejtë. Gjdo person që merrë një pensionë të caktuar qoftë për aftësi të kufizuar apo pensionë tjetër mundet me marrë shërbime Juridike Falas në të gjithat lëmit si lëmi në vijë e trashë ndahen civile, penale, administrative, kundërvajtje pastaj ndahen të drejtat në gjdo të drejtë më saktësisht gjdo shërbim që e jep zyra e Avokatit privat tek zyra jonë shërbimin e jepin falas si kërkesa, ankesa, deklarata, padia e qfarëdo parashtrere.

Përveq personave me aftësi të kufizuar që e marin pensionin nga skemat pensionale të Republikës së Kosovës ne mundemi me i ofruar shërbim juridike edhe një zyrtari të shtetit përshembull Komunës vetëm që konsiderohet si kategori sekondare mirëpo duhet me plotësuar kriterin financiar për me plotësuar duhet me sjellur një dëshmi që është me obligime financiare përshembull ka kredi ka antarë të familjes që duhet me mbajtë gruanë, fëmijët me atë pagë e pastaj ne e kalkulojmë të gjitha obligimet kontratën e punës ne i shqyrtojmë pagën nëse bie në

kategorinë e pagës minimale e cila është 350€(tre qind e pesë dhjetë euro) në Kosovë sipas vendimit të Qeverisë edhe ne i ofrojmë shërbim Juridik Falas.

Kështu që është një institucion thuajse më i miri në kontinentin e Evropian për këto shërbim që i ofronë,sepse në disa shtete të Evropës ofrohet në formë gjysmake vetëm në një lëmi në lëmit e tjera duhet me bërë pagesë .

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani:A mendonë që është mirë edhe tek ne mu bërë një gjë e tillë?

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Tek ne është diskutuar mirpo nuk ka ende ndonjë planë të tillë.

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani:Sa mendonë që janë të informuar qytetarët e Komunës së Malishevës për funksionimin e kësaj zyre sepse ka banorë në fshatra rurale që kanë nevojë mirëpo nuk kanë njohuri rreth këtij shërbimi?

A kanë planifikuar ndonjëherë prej zyrës tuaj me bërë ndonjë sesion informimi nëpër këshillat lokal që janë sepse është e pa mundur me i mbajtë 22 takime me këshillat lokal sa janë ose të paktën me mbajtë ndonjë takim me ata me i ftuar kryetarët e fshatrave me mbajtë një sesion informues?

Unë vitin e kaluar kam propozuar që me ardh në Asamblenë Komunale me bërë një prezantim të punës edhe aktivitetit që e bënë kjo zyre,besoj që është e mirë sepse mendoj që të paktën mundet me pas edhe asambleista që nuk kanë njohuri rreth funksionimit të kësaj zyre me marrë informata kush mundet me i gëzuar këto benifite.

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Shumicën e përfaqësuesëve që punojnë kemi edhe bashkëpunim më njohin që jam zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas e dinë për shërbimin që e ofrojna kam pasur shumë takime trajnime në këtë qështje.

Javën e kaluar kanë organizuar një takim me disa gra fermere të Komunës tonë dhe aty i informova për sistemi dhe rëndësinë e Ndihmës Juridike Falas në Komunën e Malishevës.

Kështu që ka nevoj për senzibilizim më tepër me bërë sepse ky shërbim nuk do të ndalet asnjëherë mirëpo për shkak të mungesës së zyrtarëve dhe kapacitetit me qenëse jam i vetëm në zyre dhe kam angazhimeve të mëdha nuk mundem shumë qështje me i realizuar.

Në Rahovec e kemi pasur një takim javën e kaluar sipas një rregullore të re që është nxjerrur për mekanizmat kordinues lokal për Mbrojtje nga Dhuna në Familje është rregullore e Qeverisë edhe në kuadër të asaj rregullores Kryetari i Komunës organizonë takime.

Ka qenë takimi i parë që është mbajtur në Komunën e Rahovecit i kryesuar nga Kryetari i Komunës dhe atje i kemi informuar për Zyrën për Ndihmë Juridike Falas.

Unë jam i hapur për gjdo kërkesë apo bashkëpunim të secilit për ofrimin e shërbimit për Ndihmë Juridike Falas.Plane nuk kemi bërë diqka por jemi të gatshëm për gjdo takim ose informim që ka nevojë me ofruar.

Një herë e kemi diskutuar këtë qështje në Asamble mirëpo ka qenë një procedurë që është kërkuar që fillimisht unë me bërë një kërkesë tek Kryesusi i Asamblesë pastaj me aprovu kërkesën dhe një ditë të caktuar me ardh me informuar Kuvendin e Komunës së Malishevës për zyrën e ofrimit të shërbimit juridik falas.Besoj që në këtë vitë do ta realizojmë këtë qështje.

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani:Besoj që këtë vitë do të realizohet sepse jemi edhe në prag të fushatave zgjedhore në nivelin lokal.

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Për mua kjo personalisht nuk ka rëndësi sepse unë nuk e përfaqësoj politikën,unë i zbatoj të drejtat e njeriut sepse pozicioni jonë i tillë nuk na lejonë me u marrë me politik.

Politika e ka fushën e vet akterët e saj politik.Ne i përkasim drejtimit ligjor.

Sakibe Kryeziu antare nga Komiteti për Komunitete:Sa jeni të kënaqur që i ndihmoni qytetarët për Ndihmë Juridike Falas ?

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Unë jam i kënaqur mirpo ka raste kur palët mendojnë që edhe ne përfitojna nga x raste ka të tillë që mendojnë ashtu mirëpo ne jemi zyrtar tani me aktemrimet e reja me të cilën titulli im i vendit të punës është Zyrtar i lartë për Ndihmë Juridike Falas jam me qëndrueshmëri të përhershme me akt emërim paguhem nga thesari i shtetit sikurse gjdo zyrtar tjetër publik i shtetit të Kosovës.

Unë ndihem i lumtur kur ndonjë palë përfitonë nga veprimet e mia ndonjë të drejtë.Kemi një rast kur një palës në mënyrë retroaktive ju kanë ribursuar afërsisht 5000€ (pesë mijë euro) tek qështja e pensioneve aty e kam orientuar palën ka shkuar ka dorëzuar dokumentet e nevojshme letrat e konfirmimit dhe numrin e gjirologarisë bankare atje në Dapartamentin e Pensioneve pastaj palës ja kanë ribursuar mjetet dhe unë kam qenë shumë i kënaqur që pala ka përfituar sepse kjo është një ndër kategoritë më të ndjeshme të shoqërisë sepse nga ajo shumë i kanë shkuar për shërbime shëndetësore siq janë barnat etje.

Kemi raste kur ju ndihmojë palës për përpilim e kërkesës për subvencionim drejtuar zyrës së Kryetarit të Komunës ose Asamblesë për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor,pastaj kur ndëgjojë palën se ma kanë aprovuar kërkesën Komuna ndihem shumë i lumtur sepse nuk dua të emëtohem në punën time sepse ajo është një sukses mirëpo shumë rrallë i tregojë zyrës qëndrore për raste të tilla vetëm kur na kërkojnë sepse nuk kërkojë me ngritë poena në atë aspektin kur unë i ndihmojë një qytetari që ju ka njoftur e drejta.Ndihem i lumtur që ju ka aprovuar nga veprimet e mia një e drejtë një qytetari.

Me qenëse jam në takim me Komitetin për Komunitete dhe Kthim dua të theksojë se unë në Komunën tonë ju kam ndihmuar të gjithëve pa dallim kombësie pa nënqimim të gjithë janë të mirëseardhur edhe ata që kanë leje qëndrim të përkohshëm sepse ligji na inplikonë me ofru shërbim juridik falas e ka lejën e qëndrimit të përkohshëm kurse nuk e ka shtetësinë ju japim ofrim të shërbimit juridik falas .Ka raste të zyrës për Komunitete dhe Kthim dhe kjo zyre na inplikonë rregulloren e tyre që rastet e tilla nëse kanë nevojë për një kërkesë,ankesë të caktuar me ju ofruar ndihmë juridike falas ose rastet e integritit kur kthehen në Kosovë këto ditë e kam pasur një rast kur bashkfshatari im është kthyer nga shteti i Italisë e kam orientuar këtu tek zyrtarja në Komunën e Malishevës mirëpo si rast nuk e kam rregjistruar sepse ka ndodhur takimi jasht zyrës mirëpo e kam orientuar të paktën si këshillim.Tani i kam thënë nëse të duhet nevoja për një shkresë në bazë të atyre të drejtave që i kërkonë Zyra për Kthim dhe Rintegrim vjen tek unë dhe të ndihmojë sepse janë kategori që duhet me ju ndihmuar.

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani:Faleminderit shumë i nderuar besoj që të gjitha informacionet që ofronë kjo zyre të gjitha kategoritë që i gëzojnë këto shërbime u informuanë edhe antarët e këtij komiteti besoj që është mirë të gjithë me i shpërnda këto

informacione me banorët që kanë nevojë për këto informacione të cilët kanë kërkesa ju pysin rreth këtyre problemeve.

Unë ju falenderoj në emër të gjithë antarëve të Komitetit për Komunitete për kohën për kontributin që e keni dhënë në këtë takim.

Patjetër që edhe ne jemi të gatshëm me bashkëpunu, qytetarët që kanë nevojë me i ndihmuar ne do ti orinetojmë në zyrën tuaj përkatëse. Unë personalisht kam pasur raste që kam udhëzuar pensionistat kur kanë pasur probleme me pensione të dyfishta dhe ata janë ndjer shumë mirë që në Komunën e Malishevës egzistonë një zyre e tillë për ofrimin e këtyre shërbimeve.

Unë edhe njëherë ju përgëzoj për punën, vullnetin dhe angazhimin që e bëni në atë zyre uroj që me pasur sa ma pak raste me probleme por sa ma shumë dyer të hapura për qytetarët është një mundësi më e mirë që me jetuar qytetarët në shtetin e Republikës së Kosovës.

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas: Ju falenderoj shumë për këtë takim, unë e qmoj shumë bashkëpunimin me akterët brenda Komunës sepse edhe ju edhe Zyra për të Drejtat e Njeriut por edhe zyrat e Administratës më dërgojnë shumë raste kemi takime të qasshme informohen për zyrën më kanë ardhur shumë palë i kam ndihmuar. Unë nuk e kufizoj edhe në qoftëse është palë që nuk duhet me ju ofru Nihmë Juridike Flas nëse e ka dërguar dikush nga akterët për një mundësi që ti ofrohet ajo mundësi unë nuk e kufizoj edhe ja ofroj thjeshtë në kuadër të bashkëpunimit sepse mundet me qenë vështërsi e caktuar financiare e personit ose e rrethanave të tjera ajo qka është në aspektin profesional në mundësit dhe veprimet e mija unë nuk kufizohem i ndihmoj për qytetarët e Komunës së Malishevës.

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helashani: Ju falenderoj shumë edhe një herë zotri Agron Kastrati.

Pika e tretë e rendit të ditës : Vizitë në HANDIKOS në Malishevë.

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani: Këtë pikë të tretë të rendit të ditës e kalojmë pasi që kemi me shkuar për vizirë në HANDIKOS në Malishevë tek drejtoresha Feride Hoxha.

Pika e katër e rendit të ditës : Të ndryshme .

Kryesues i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani: A ka dikush ndonjë diskutim propozim?

Unë tek pikat e ndryshme dëshiroj me prezantu një punë të mirë të qytetarëve të Komunës së Malishevës vërtetë banorët në fshatrat e Komunës së Malishevës gjithëandë kanë shpirtin e vullnetarëve, shpirt human janë shumë të përkushtuar në komunitetin të cilën jetojnë dhe veprojnë në bazë të informimeve qka i përcjelli në rrjetet sociale edhe vizitat në teren po e shoh një vullnet të jashtzakonshëm të banorve gjithëandë po i përmendi disa nga fshatra të cilat janë Pagarusha, Dragobili, Bellanica, Ngucati, Vërmica e shumë fshatra të tjera të cilat nuk po i përmendi me emra të cilat e kanë një organizim të jashtzakonshëm sa i përket promovimit të punës dhe vullnetit të mirë që e kanë për me përmirësuar infrastrukturën dhe ambientin e qytetarëve ku ata banojnë.

Ne nganjëherë duhet me shti ne funksion atë pytjen se qfarë po bënë shteti për mu?

Por edhe ne duhet nganjëherë me bërë pytjen se qfarë po bëjmë ne për shtetin ku ne po jetojmë dhe veprojme ?

Por sigurisht që përmes këtij komiteti unë do të rekomandojë edhe tek Kryetari i Komunës së Malishevës gjithashtu edhe në nivel qendror sepse këta qytetarë meritojnë që secili fshat në Komunën e Malishevës meritojnë me pas nga një puntorë të angazhuar për mirëmbajtjen e mjedisit e që një projekt i tillë ka qenë në funksion dikur por për shkaqe të ndryshme është ndërpre e duke e pasur parasysh këtë vullnet të krejt këtyre banorëve sepse harova me cekë Bellanicën që kanë puntorë dhe e pagujnë me fondin e vet puntorin.

Përderisa ne punojmë në bazë vullnetare për komunitetin në përgjithësi atëherë është mirë edhe shteti me angazhu puntorë në mirëmbajtjen e këtyre hapsirave publike sepse është shumë lehtë me ndotë por vështirë me mirëmbajtë qoftë një parkim apo hapsirë që shfrytëzohet prej qytetarëve.

Nuk kanë nevoj banorët e fshatit nga fondi i tyre që grumbullojnë me pagu një puntorë përderisa këtë shërbim e bënë dikush nga banorët e fshatit thjeshtë me paguar nga fondi i shtetit me angazhuar puntorë në bazë të projektit të caktuar siq ka qenë më herët pastrimi i pyjeve,malet e Berishës sot ato pyje janë bërë për mrekulli një ambient i jashtëzakonshëm kështu që me një projekt të vogël përfitojnë shumë qytetarë edhe vet vendi.

Unë kam bërë një pyetje në Kuvendin e Komunës pse nuk janë aktiv antarët e këshillave lokal? Në disa këshilla lokal janë duke funksionuar në mënyrë vullnetare kurse zyrtarisht nuk janë këtë përgjegjësi duhet me bartë dikush por duhet me u vlerësu prej secilit dikaster kjo punë vullnetare që secili njeri e humb kohën e tij të qmuar ku prej secilit sot koha është e kufizuar.

Nuk dëshiroj me qenë lokalistë sepse me qëllim e përmenda fshatin Pagarushë,Dragobilin por e përmendi edhe Ngucatin për dy javë janë realizuar dy projekte me kostonë mbi 20,000.00€(njëzetë mijë euro) janë donacione vullnetare janë mbi 500 metra katrorë oborri i shkollës donacion vullnetarë por unë kam pasur kënaqësi me ftuar Kryetarin e Komunës jo për të bërë fushatë por me shikuar një punë të mirë qfarë janë duke e bërë qytetarët e atij fshati por edhe Pagarusha edhe Dragobili edhe Bellanica kanë hapsira shumë të mira të cilat po i shfrytëzojnë edhe shumë mirë që këta banorë nuk i kanë ozurpuar hapsirat publike dhe kështu secilim këshill le të mbetet në cilësinë e inspektoriatit në Komunën e vet.

Në fshatin Ngucat kështu veprojnë këshilli organizativë ,unë personalisht e kam prishur murin dhe kam lëshuar hapsirën publike dhe kam qëndruar për aq sa më takonë prandaj e ceka këtë temë diskutimi tek qështjet e ndryshme .

Agron Kastrati zyrtar nga Zyra për Ndihmë Juridike Falas:Në fshatin tonë së fundi në Turiak është organizuar një shoqat mirëpo statusi i saj është OJQ e cila ka kërku nga qytetarët me participu me donacion për mirëmbajtje të varrezave,rugëve .

Disa qështje i kanë rregulluar sa kam informacion sa kam dëgjuar që e kanë kontraktuar një biznes që përbrenda një viti sipas një shume të caktuar për me mirëmbajtë varrezat dhe disa rrugë të caktuara të fshatit kjo qështje është shumë e mirë kur organizohen banorët vet ose shoqatat e tilla sidomos kur nuk ka manipulime të caktuara por ka transparencë tek qështja financiare.

Kryesus i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani: Sigurisht i përmenda disa nga këto fshatra që janë transparent me publikun.

Sakibe Kryeziu antare nga Komiteti për Komunitete: Në fshatin Pagarushë në mënyrë vullnetare banorët janë duke i pastruar varrezat, malet si përshebull në mënyrë të organizuar bashkëshorti im edhe pse tani mërgimtarët nuk janë këtu shumicën e punëve duhet me i kryjtë ai vet mirëpo për shkak të obligimeve të shumta kohën e ka kufizuar sepse është edhe mësimdhënës nuk ka banorë kur vie puna ai duhet me u përfshirë në gjdo punë si busti i Negjmije Pagarushës, lapidarët, parku me mirëmbajtje sepse tani është projekti i tretë i cili thihet "Të edukojë" se sa bëhet pagesa kur e paguajnë një puntorë për me pastru ambientin nuk e di.

Kryesus i Komitetit për Komunitete Amrush Helshani : Punët e mira duhet mu vlerësu jashtëzakonisht shumë sepse janë punë të mira që po i gëzojnë banorët e fshatrave është kënaqësi me shku në fshatin Pagarushë dhe në momentin që hynë në fshat e mer një pajme jashtëzakonisht mahnitëse është gjithashtu Mulliri i Zenelit ka edhe vende të tjera njejtë edhe në fshati Dragobil në fshatin Ngucat keni me takuar kurorën e Maleve të Berishës është kompleksi Kodra e UÇK-së e cila është bërë financiarisht nga fondet e qytetarëve pa dallime nga diaspora nga vendasit e kanë ndjerë një obligim me përkrahë këtë iniciativ e disa projekte të tjera të cilat të bëjnë mu ndje shpirtnisht shumë mirë edhe me jetu dhe kontribu në vendin tonë edhe njëherë shumë faleminderit zotri Agron Kastrati për kontributin e juaj.

Nëse nuk keni me shtuar diqka tjetër me kaq po e mbylli takimin për sot.

Takimi përfundoi rreth orës :11:20.

Procesmbajtësja

Fatlume Delija



Kryesus i Komitetit për Komunitetit

Amrush Helshani

